

RIKTHIMI I MOTIVEVE MITIKE NË LETËRSI RASTI I ROMANIT “URA ME TRI HARQE”

Hyrje

Rimarrja e motiveve mitike në krijimtarinë letrare bashkëkohore, dhe jo vetëm, është dukuri e njohur dhe e studiuar mjaftueshëm në letërsi. Motive të tilla janë të pranishme në shumë prej veprave të Ismail Kadaresë, ose thënë ndryshe, kanë qenë një sofër prej së cilës është ushqyer vazhdimisht dhe e ka plotësuar veprën e tij të pavdekshme. Metafora mitike, është pjesë tejet e rëndësishme për kuptimin dhe interpretimin e letërsisë. Shkrimtarët e mirëfilltë, shpeshherë, rimarrin motivet mitike si paratekste letrare, e pastaj i përdorin për qëllimet e tyre, duke u kujdesur për fabulën ekzistuese, ngase ndryshime të çfarëdollojshme do ta humbnin interesin e lexuesve. Ja si shprehen teoricienët e shquar të letërsisë:

“Të thuash se shkrimtari ka nevojë për mitin, është shenjë e nevojës që ai ndien për t’u bashkuar me shoqërinë, për të gjetur vendin e vet në shoqëri, për t’u integruar në të”.¹

Përveç kësaj, kemi raste edhe kur shkrimtarët me aftësi të veçanta arrijnë që të krijojnë mite të paqena, por të krijuara nga vetë ata, e që pastaj nëpërmjet lexuesve marrin përmasa universale. Për t’u theksuar është edhe fakti se

“ka mite të krijuara me tendencë, po ka edhe të krijuara në mënyrë të pavetëdijshme”.²

Në fokus të punimit tonë s’ka si të jetë rasti i fundit, ngase dihet fare mirë se motivet të cilat janë proceduar në tekst nuk janë prurje të reja, por janë marrë nga opusi ynë i gjerë folklorik.

¹ R. Wëllek, A. Warren, *Teoria e letërsisë*, përktheu nga origjinali: Abdurrahman Myftiu, Tiranë, 2007, f. 198.

² Doc. Todi Dhama, *Fjalor i mitologjisë, “Rilindja”*, Prishtinë, 1988, f. 11.

Krijimtaria folklorike ka qenë përherë tërheqëse dhe motivuese për I. Kadarenë. “Balada e murimit” zë vend qendror në letërsinë orale, që njëkohësisht është edhe një ndër krijimet më të bukurat që ka populli ynë. Këtu, padashur të futemi në gjenezën e saj, themi se ajo është ricikluar për t’u proceduar me mjeshtëri të mrekullueshme në roman, që njëkohësisht është edhe një ndër veprat më të arrira të Kadaresë. E natyrisht, përveç aftësisë së jashtëzakonshme krijuese të shkrimtarit, meritë e qëndrueshme është edhe motivi i autorit që përbën subjektin e romanit.

Domethënia e miteve

Popujt përgjatë rrugës së zhvillimit dhe emancipimit kanë krijuar thesare me materiale shpirtërore. Gjeneza e tyre lidhet me stadin fillestar të mendjes njerëzore, pra me një shkallë shumë të ulët, kur mendja nuk ishte e aftë të shpjegonte shkaqet e vërteta të dukurive të botës reale.

“Në këto kushte, krijimi i një realiteti të dytë përmes fantazisë ishte një nevojë objektive”.³

Nga këndeje lindën mitet.

“Të studiosh mitet do të thotë të hulumtosh mbi mënyrën se si e paraqesin njerëzit veten e tyre dhe marrëdhëniet me botën ku rrojnë. Nuk mund të zbërthehet dhe të analizohet një mit pa bërë kërkime mbi funksionin që ai kryen në kontekstin në të cilin ai rrijojen, aktualizohet”.⁴

Fjala “mit” vjen nga greqishtja **mithos** d.m.th. fjalë a bisedë, që në një kuptim më të gjerë të fjalës do të thotë tregim, fiksjon (fiction), mendim etj., ose thënë me fjalë të tjera, mitet

“janë rrëfenja, histori, parafytyrime të mbinatyrshe, të sendeve e të dukurive të caktuara”.⁵

Do theksuar se në arsenalin e mitit hyjnë edhe shumë qenie që bëjnë fjalë për krijesa të mbinatyrshe, bimë, kafshë apo përbindësia.

³ Po aty, f. 3.

⁴ Dr. Viola Isufaj, *Rikthimi i mitit në veprën e Ismail Kadaresë, “Onufri”*, Tiranë, f. 21.

⁵ Mark Tirta, *Mitologjia ndër shqiptarë, “Mësonjëtorja”*, Tiranë, 2004, f. 7.

Problem në vete është edhe qasja e definimit të mitit. Thjesht, “miti nuk definohet nga objekti i mesazhit të tij, por nga mënyra në të cilën e shpreh këtë mesazh”⁶. Në rastin tonë, shprehësia e mesazhit të mitit nga autori është pjesa esenciale, dhe, domosdoshmërisht përbën edhe thelbin e domethënies së mitit të murimit të shtrirë në roman.

Funksioni dhe rimarrja e miteve

“Rikthimi te motivet e vjetra, ndonëse në vështrimin e parë mund të duket i lehtë, është një nga gjërat më të vështira në letërsi. Dalta mezi e gërvisht gurin mijëvjeçar. Një qëndresë e kobshme, një kundërpërgjigje kërcënuese vjen që nga thellësitë, i kalon krahut tënd, e pastaj krejt ndërgjegjes tënde, mbi të cilën nis të pllakosë ankthi”⁷. Interpretimi apo shqyrtimi i miteve ka qenë synim i kamotshëm i antropologjisë kulturore. Dihet fare mirë se çdo qytetërim, pa marrë parasysh shkallën e zhvillimit kulturor, shoqëror apo edhe ekonomik, identifikohet apo njihet botën nëpërmjet sistemeve vetjake. Sisteme të tilla, janë si të thuash fryte të krijuara ndërmjet individit dhe shoqërisë, që nga ngjizja e gjinisë njerëzore, e të trashëguara brez pas brezi për të arritur deri në ditët e sotme.

“Vëmendja e veçantë e letërsisë dhe e mendimit filozofik të lashtësisë ndaj miteve ishte krejt e vetvetishme, sepse, siç dihet, në ato kohë mitet besoheshin si e vetmja e vërtetë që shpjegonte ç’ kishite ndodhur e ç’ ndodhte me botën e me njerëzit”⁸.

Interesi për mitet dhe mitologjinë e popujve është edhe sot e kësaj dite në rritje, si shkak për t’u marrë me enigmën e njeriut dhe me të kaluarën e tij të hershme, kjo për arsye se

“mitet janë pjesë e rëndësishme e kujtesës së njerëzimit; në botën e tyre semantike dhe poetiko-simbolike, gjenden

⁶ Rolan Barthes, *Miti sot*, përktheu nga anglishtja: Ballsor Hoxha, revista letrare “Jeta e re”, nr. 2, Prishtinë, 2013, f. 296.

⁷ Ismail Kadare, *Ftesë në studio*, “Onufri”, 2012, Tiranë, f. 157.

⁸ Ali Xhiku, *Pak fjalë për marrëdhëniet e traditës me mitologjinë*, revista shkencore-kulturore trimujore “Perla”, nr. 3 (42), viti XI i botimit, 2006. Botues: Fondacioni Kulturor “Saadi Shirazi”, Tiranë, f. 47-51.

të përjetësuar disa shenja dhe informacione që lidhen drejtpërdrejt me stadin kulturor të foshnjërisë së shoqërisë njerëzore”.⁹

Në rastin tonë, rimarrja e motivit të baladës së murimit dhe futjes së saj në një kontekst të ri e të paqenë, është ndërtuar në roman në formën e kronikës, me qëllim që të pasqyrojë jetën dhe funksionin e individëve në shoqërinë e asaj kohe; kjo formë nuk mungon edhe në pjesën tjetër të veprës së Kadaresë, për të mos thënë se zë vend primar në të. Protagonisti, me emrin Gjon Ukcama, del e zotohet se do ta shkruajë historinë e urës mbi Ujanën e Keqe. E gjithë historia shkruhet nëpërmjet rrëfimit si formë kujtimesh nga murgu, për t’i lënë vend edhe zbulimit të të rejave që kanë ndodhur më parë.

Ja disa nga të dhënat për stadin kulturor dhe botën semantike dhe simbolike që nxjerrim nga romani për shqiptarët e asaj kohe:

- Mendimi kolektiv që sillte regres për shoqërinë. Sekuenca të shumta na e tregojnë këtë fakt;
- Izolimi total me botën. Bëmat e botës tjetër, banorët i dëgjojnë shumë rrallë, edhe kur ato i pranojnë, ose janë të shtrembëruara, ose të pavërteta, ose të keqkuptuara;
- Natyrorja si mjet lidhjeje me hyjnoren. Një sëmundje njerëzore nënkupton një mallkim hyjnor. Një rrjedhë më e fuqishme e lumit nënkupton zemërimin e Perëndisë etj.;
- Tejkalimi i politeizmit. Ndonëse çdo veprim a situatë e krijuar merr përmasa sakrale, pra sakralizohet, megjithatë monoteizmi dëshmohej si besim.

Gjithë këto të dhëna, autori i sjell vetëm duke u mbështetur te mitet. Natyrisht, ka edhe të dhëna të tjera që ne nuk i kemi paraqitur këtu e që gjenden në roman, mirëpo ato nuk na vijnë prej burimeve mitologjike, por prej burimeve të tërthorta.

Folklori si burim mitesh

Para së gjithash, mund të themi se në themel të veprave artistike qëndron një pjesë jo e vogël e formave dhe e krijimeve popullore.

⁹ Prof. Dr. Adem Jakllari, *Leksione për antropologjinë kulturore*, SHBLU, Tiranë, 2010, f. 159.

Pra, është e qartë që folklori ka ushtruar ndikim të vazhdueshëm dhe ka një rol të rëndësishëm dhe progresiv në letërsinë e një vendi. Këngët legjendare të murimit apo edhe epikat e mëdha, kanë në përbërje të tyre lëndë të mirëfilltë mitike. Problemi letërsi - mitologji, është i lidhur ngushtë edhe me problemin e letërsisë me folklorin.

Realiteti i caktuar i fenomeneve natyrore që nga historia e hershme e gjenezës njerëzore, ka arritur deri në ditët tona kryesisht nëpërmjet krijimtarisë gojore, veçanërisht është *“bartur përmes këngës”*.¹⁰

“Të befason gjallësia e poetikës së mitologjisë popullore dhe aftësia e vlerave të saj për t’u ndërfaqur, sidomos përmes folklorit, në traditën e letërsisë sonë të kultivuar, duke i veshur shpesh një kolorit të veçantë kombëtar”.¹¹

Ajo të cilës rapsodët shqiptarë, ndër më të shquarit në Ballkan, dhe jo vetëm, i kënduan me plot jetë e dashuri ishin bëmat heroike të njerëzve të popullit të tyre. Kështu ngjau edhe me *“Baladën e murimit”*, që e nisi jetën e vet në telin e lahutës dhe çiftelisë, jehoi nga bjeshka në bjeshkë, nga qyteti në qytet, e kështu vazhdoi me vite e vite derisa u konkretizua në tekst për të mbetur e dokumentuar, edhe si fakt, edhe si vlerë e rëndësishme popullore. Në anën tjetër, aktivizimi i lëndës mitologjike kërkon të modifikohet, përpunohet dhe të rikrijohet lënda për të arritur pikësynimet krijuese, në të kundërtën do të ishte thjesht përsëritje, pa na dhënë përthyerjen dhe refleksionin e lëndës. Lënda e tillë mitike qëndron në shumë prej veprave të shkrimtarit që kemi për objekt: si në romanet *“Kush e solli Doruntinën”*, *“Nëpunësi i pallatit të ëndrrave”* dhe *“Ura me tri harqe”*.

Paralajmërimet mitike

Para ndërtimeve të urave prej guri, njerëzit kanë përdorur ura të improvizuara prej druri apo edhe trape, ashtu siç na del në roman. Lumi mbi të cilin ngrihen ngrehinat, qofshin prej druri apo guri, shpreh në mënyrë simbolike kufirin në mes botës së

¹⁰ Zef Mirdita, *Mitet dhe mitologjia në antikë*, “Rilindja”, Prishtinë, 1988, f. 72.

¹¹ Alfred Uçi, *Mitologjia, Folklori, Letërsia*, “Naim Frashëri”, Tiranë, 1982, f. 221.

gjallë dhe të vdekur, uJORëve dhe tokësORëve. Konflikti mes këtyre botëve në kufij, merr kuptim denotativ.

Kronika e shkruar nga Gjon Ukcama, del si histori e përfunduar, dhe në roman na vjen në trajtë rrëfimore, konform definicionit të kohës reale. Vendi që planifikohet për ta ndërtuar urën paraqitet nga autori si vend fiktiv, Ujanë e Keqe.

Nëpërmjet gojës së Ukcamës, autori rrëfen se që nga dita e parë kur u hap lajmi për ndërtimin e urës, madje edhe para saj, atëherë kur një personazhi i kishte rënë sëmundja e tokës, prej të cilës dridhej e shkumëzonte, një i pranishëm ishte shprehur se: *“Kjo është një shenjë nga lart”*.¹² Simbole të ngjashme, deri në klimaksin e veprës, na japin shenja paralajmërimi, si përmes rapsodëve, mallkimeve të shumta të plakës Ajkunë etj.

Krahas përhapjes së gjerë të baladës, në roman hasim ndalimin e reflektimit të mesazhit mitik, tanimë me përmasa universale, luftuar nga kisha ortodokse. Duket sikur në të gjitha trajtat e paraqitjes së tyre, subjektet e tilla përpiqen të jenë triumfuese në shoqëri dhe gjithsecili prej tyre kërkon primatin. Gjersa kisha ortodokse përpigëj ta ndalonte baladën, *“balada këndohej kudo në krentimet e pashkëve”*.¹³ Ngjashëm me gacën, sado që i fryhet për ta shuar, ajo ndizej edhe më shumë.

Natyrshëm, një pjesë e rëndësishme e paralajmërimeve vjen nga rapsodët të cilët këndonin te *“Bujtina e Robertit”*. Ata, dalëngadalë, *“Baladën e Rozafatit”* po e ritekstualizonin, duke kërkuar flijim të ri, gjë e cila do të shfaqet si dekonstrukcion i lëndës mitike. Në mënyrë të përgjithshme, nga këtu, mund të dalim në përfudnimin se:

“...simbolet dhe imazhet mitike janë një matricë dominante në universin letrar kadarea, dhe ky tipar i jep asaj një përmasë bukur të dallueshme në një përjasje komparative me letërsinë e mëdha”.¹⁴

¹² Ismail Kadare, *Ura me tri harqe*, Vepra 10, “Onufri”, Tiranë, 2008, f. 26.

¹³ Ismail Kadare, *Ura me tri harqe*, Vepra 10, “Onufri”, Tiranë, 2008, f. 86.

¹⁴ Adem Jakllari, *Imazhi mitik i botës dhe ritmet kozmike në veprën e Kadaresë*, Materialet e punimeve të Seminarit XXXIII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare Prishtinë, dt. 18-30.08.2014, Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”, Prishtinë, 2015, f. 25.

Flijimi në ndërtim si subjekt mitik

*“Letërsia u mësua të kërkojë fli.
Në një mënyrë ose në një tjetër,
ajo na kërkon ne. Në një mënyrë
ose në një tjetër ne i paguajmë kontributin”.*¹⁵

Zhvillimi dhe rindërtimi i lëndës mitologjike nuk duhet t'i largohet skajshmërisht autenticitetit mitik. Në qendër të baladave të murimit është flijimi i njeriut në ndërtimin e urave, kishave dhe kështjellave.

Mendimi se pas çdo ngrehine duhet bërë sakrificë është i njohur ndër ne.

*“Në traditën antropologjike ballkanike, ura, si të gjitha ngrehinat e gurta, për t'i qëndruar kohës e për të mos u shembur duhej pajisur me një shpirt, duhej shpirtëzuar, duhej “të dridhej”, siç thotë Kadareja duke cituar baladën”.*¹⁶

Ky mendim kryekëput na është paraqitur në vepër, ngase

*“letërsia nuk është pasqyrë e realitetit, por njohuri mbi këtë realitet, që shfaqet si një tërësi dialektike e pjesëve që janë në lëvizje dhe në kontradikta”.*¹⁷

“Përpjekja e I. Kadaresë për të përpunuar në mënyrë krijuese në prozë subjektet e disa baladave me elemente mitologjike është interesante, por në “Urën me tri harqe”, legjenda e murimit është përdorur e zhvilluar me sukses”.¹⁸

Në urën e Ujanës së Keqe, për dallim nga gojëdhënat, miti na del i dekompozuar, sepse “i flijuari” Murrash Zenebishta, nuk na paraqitet fillimisht si genie e gjallë, e pastaj për t'u flijuar për urën,

¹⁵ Fatmir Alimani, *Katër K: Kafka, Kavabata, Kundera, Kadare, Ese, “Onufri”*, 2005, f. 2010. Cituar sipas: Dr. Ermira Ymeraj, *Komunikimi i kodit të flijimit në letërsi si tekst origjinal (I. Kadare, I. Andriq, K. Varnali, R. Qosja)*, Punim nga Konferenca shkencore kushtuar Akademikut Idriz Ajeti, mbajtur në Universitetin “Ukshin Hoti”, Prizren, Fakulteti i Filologjisë “Vertigo”, Prizren, 2015, f. 254.

¹⁶ Matteo Mandalà, *Urat krontopike kadareane*, revista “Hora e Arbëreshëvet”, tetor 2008. Në veprën e Kadaresë, *Ura me tri harqe*, Vepra 10, “Onufri”, Tiranë, 2008, f. 19.

¹⁷ Floresha Dado, *Letërsi e painterpretuar*, “Bota Shqiptare”, Tiranë, 2010, f. 118.

¹⁸ Mark Tirta, *Mitologjia ndër shqiptarë*, “Mësonjëtorja”, Tiranë, f. 390.

por një kufomë e murosur që ishte vrarë më parë.

*“Të paktë janë ata që e dinë se kjo nuk ishte një fli kushtuar orëve të ujit, por thjesht një krim i zakonshëm, dëshmitar i të cilit dhe i gjërave të tjera unë do të bëhem përpara mijëvjeçarit tonë. Them të mijëvjeçarit, sepse kjo është nga ato lloj gojëdhënash që arrin të jetojë mbi një mijë vjet. Kryet e ka në vdekje dhe bishtin në vdekje, dhe dihet fjala ose tingulli i ngjizur me brumin e vdekjes, më pak se çdo gjë tjetër i trembet asaj”.*¹⁹

Motivi i ndërtimit të urës paraqitet me ngjyra banale, sepse qëllimi është përfitim ekonomik. Objekt flijimi nuk është një nënë apo një grua, siç ndodh zakonisht, por një njeri i rëndomtë, më se i rëndomtë. Murrashi muroset në këmbim të shpërblimit. Në roman, për dallim nga miti, “i fljuari” nuk është vendosur në urë i gjallë. Pra, është murosur një kufomë. Akoma më banale e bën situatën pohimi i nënës së Murrashit:

“ - Ka gjasa ta ketë vrarë dikush? - i thashë me zë të ulët.

Po përse?

Ajo fshiu lotët.

-Përse? Ku ta di unë e gjora përse. Me siguri kot. Se bënte hije mbi dhë”.

Në anën tjetër, në roman ndeshim edhe devijimin e ujit apo edhe trazimet e tjera nga punëtorët që e prishin hijeshinë dhe harmoninë e vendit në sytë e banorëve. Kësisoj, përmes këtyre elementeve arrihet të desakralizohet parateksti.

*“Një veshje mitike mund të ketë një qëllim krejt tjetër”*²¹.

Edhe pse ura në roman vjen e çmitizuar, ajo lidhet me vdekjen, ndryshe nga balada ku i fljuari i përcjell jetën ndërtimit.

“Ka një logjikë të caktuar tek miti dhe formulimet e tjera mund të shkojnë deri në kundërshtim me tekstin fillestar”.

¹⁹ Ismail Kadare, *Ura me tri harqe*, Vepra 10, “Onufri”, Tiranë, 2008, f. 22.

²⁰ Po aty, f. 108.

²¹ Yves Chevrel, *Letërsi e krahasuar*, “Albini”, Tiranë, 2002, f. 89.

²² Eva Dardha, *Motivi i murimit në romanin Ura me tri harqe të I. Kadare*, Tiranë, 2015, f. 14. Shfletuar në: http://www.academia.edu/36441924/Motivi_i_muri_-_mit_ne_romanin_Ura_me_tri_harqe_I._Kadare. Së fundi, më 27.05.2018.

kjo kuptohet vetëm nga lexuesi i kujdesshëm, apo për të përdorur termin e Ecos, lexuesi model, sepse përgjatë gjithë romanit *“intonacionet gjuhësore, struktura figurative, frazeologjia dhe leksiku janë tipike për materialet e mitologjisë. Shpejtësia e përdorimit të leksikut të tillë (shënimi im, F.R.) është e madhe”*.²³

Kështu lënda e rimarrjes paraletrare, vjen si një lëndë e riinterpretuar, rikonstruktuar për vetëdijen moderne që ka autori në vete dhe në raport me lexuesit e tij.

Murimi

“Sakrifica në ndërtim bie në sy më tepër për përdorimin e saj dhe mënyrën me të cilën Kadareja ka ditur të përshtatë fabulën e hershme ndaj subjektit të romanit të tij”.²⁴

Fabulës së hershme të baladës së murimit nuk i është larguar arketipi i sakrificës, por është shndërruar në një përmasë tjetër, dhe kjo nuk e vë në kontradiktë as me traditën letrare, as me atë mitologjike.

Përfundimet e Mircea Eliade-s se asgjë nuk mund të zgjasë nëse nuk është *“e shpirtëzuar”*,²⁵ janë tepër esenciale për çështjen tonë. Hejja dhe prerja e motiveve mitike nuk përkon me baladën. Mitin e shpirtëzimit e dekomponon autori.

“Pra, mitet letrare, që rimodelon Kadareja, u nënshtrohen në një pjesë të rëndësishme, trillimeve vetjake”.²⁶

Ata të cilët do t'i japin elementet e para të rindërtimit të legjendës, përbrenda romanit, janë rapsodët.

Tanimë, në gojën e rapsodëve

“nuk ishin tre vëllezër, që ndërtonin murin e një kështjelle, por me dhjetëra muratorë, që ngrinin një urë. Ura ditën

²³ Alfred Uçi, *Mitologjia, Folklori, Letërsia*, “Naim Frashëri”, Tiranë, 1982, f. 332-333.

²⁴ Dr. Viola Isufaj, *Rikthimi i mitit në veprën e Ismail Kadaresë*, “Onufri”, Tiranë, f. 89.

²⁵ Mircea Eliade, *The Myth of the Eternal Return: Cosmos and History (Princeton Classic Editions)*. Princeton University Press, 2005, f. 54. Për këtë shih: Dr. Viola Isufaj, *Rikthimi i mitit në veprën e Ismail Kadaresë*, “Onufri”, Tiranë, f. 86.

²⁶ Dr. Viola Isufaj, *Rikthimi i mitit në veprën e Ismail Kadaresë*, “Onufri”, Tiranë, f. 172.

*ngrihet e natën rrënohej prej shpirtrave të ujit.*²⁷

Ajo kërkonte fli për hir të mijëra kalimtarëve që do të ecnin andej.

*Me një fjalë, miti duhet të ndodhë - nëse dikush mund të thotë kështu në një kohë jo-materiale...*²⁸.

Tek ura e Ujanës së Keqe, Murrashi nuk murohet si vullnetar, ose nuk muroset se kështu qe fati, siç ndodhte me personazhet e tjerë të baladave, por ai fillimisht paraqitet i vrarë, pra nuk shpirtëzohet.

*"Sakrifikimi kundrejt shpërblimit e kthen ritin në një vetëorasje, edhe kjo në një sakrilegj"*²⁹.

Kah fundi i romanit shohim se edhe pse nuk kemi shpirtëzim të njeriut kushtuar "krijesave mistike", ura qëndron, madje-madje, ajo nuk do t'i rezistojë vetëm kalimtarëve të Ujanës, por edhe batalioneve ushtarake osmane. Është e natyrshme, se tek autori kanë ndikuar motive të ndryshme që kuptimi të tjetërsohet.

"Mitemat letrare rrugëtojnë duke ndërkalur në këtë rrugëtim pasazhe kulturash, përmbajta e mitit të flijimit si mitemë origjinale, edhe kur transmodelohet është në përshtatje me rrjetin motivor mbi të cilin vazhdojnë e thuren kulturat".³⁰

Mund të arrihet deri aty, sa të thuhet se: "ndoshta morali i mitit duhet të ndryshojë, asnjë ndërtim i ri nuk është i shenjtëruar sa kohë ai ngrihet mbi jetën e dikujt, individ, etni, komb".³¹ E kjo siç duket është arritur plotësisht nga autori.

²⁷ Ismail Kadare, *Ura me tri harqe*, Vepra 10, "Onufri", Tiranë, 2008, f. 98.

²⁸ Mircea Eliade, *Images and symbols, Studies in Religious Symbolism*, the english translation Harvill Press Manufactured in the United States of America, 1961, f. 57.

²⁹ Eva Dardha, *Motivi i murimit në romanin Ura me tri harqe të I. Kadare*, Tiranë, 2015, f. 12. Shfletuar në: http://www.academia.edu/36441924/Motivi_i_murimit_ne_romanin_Ura_me_tri_harqe_I_Kadare. Së fundi, më 27.05.2018.

³⁰ Dr. Ermira Ymeraj, *Komunikimi i kodit të flijimit në letërsi si tekst origjinal (I. Kadare, I. Andriq, K. Varnali, R. Qosja)*, Punim nga Konferenca shkencore kushtuar Akademikut Idriz Ajeti, mbajtur në Universitetin "Ukshin Hoti" Prizren, Fakulteti i Filologjisë, "Vertigo", Prizren, 2015, f. 262.

³¹ Eva Dardha, *Motivi i murimit në romanin Ura me tri harqe të I. Kadare*, Tiranë, 2015, f. 12. Shfletuar në: http://www.academia.edu/36441924/Motivi_i_murimit_ne_romanin_Ura_me_tri_harqe_I_Kadare. Së fundi, më 27.05.2018.

Në vend të përfundimit

Opusi kadarean është një univers letrar origjinal, tanimë, i njohur ndërkombëtarisht. Flijimi përherë ka qenë dukuri jashtëzakonisht me interes, jo vetëm për shkrimtarët dhe këngëtarët, si nevojë për t'i proceduar në krijimet e tyre, por edhe për kulturologët dhe studiuesit me qëllim interpretimi. Fakti i ndërlidhjes në mënyrë të mrekullueshme të këtyre refleksioneve me realitetin objektiv nga ana e autorit, të mahnit e të krijon përshtypjen se po e jetëson vetë këtë ngjarje.

Ndërlidhjet e shumta të mendimeve, simboleve, elementeve dhe parafytyrimeve mitike që hasen në tekst, të japin shtrëngesa të fuqishme duke ta zhvendosur shpeshherë vëmendjen në elemente të tilla. Për një kohezion të mirëfilltë, kësaj pjese po i bashkojmë edhe pasurimin e romanit me simbolin “tri”. Në fillim po japim përkufizimin e Paul Ricouer-it: “Çdo strukturë e kuptimësisë, domethënies, në të cilën një kuptim direkt, primar, literal, simbolizon, për më tepër, një tjetër kuptim indirekt, dytësor, figurativ, që nuk mund të ketë kuptim veçse në lidhje me të parin”.³²

Për një qasje ndaj simboleve krahas përkufizimit të simbolit nga P. Ricouer, na vjen në ndihmë definicioni i Mircea Eliades, që thotë:

*“Simboli zbulon aspekte të caktuara të realitetit – aspektet më të thella – të cilat sfidojnë çdo mjet tjetër të dijës. Imazhet, simbolet dhe mitet, nuk janë krijime të papërgjegjshme të psikikës; ata përgjigjen për një nevojë dhe për të përmbushur një funksion, atë të sjelljes në dritë të modaliteteve më të fshehta të qenies”.*³³

Idetë që shfaqen nga subkoshienca³⁴ reflektojnë vetë-formësimin e autorit. Nga këtej, çdo fjalë duhet analizuar në kuptimin sekondar, dhe jo në kuptimin primar.

³² Cituar sipas: Prof. Dr. Adem Jakllari, *Leksione për antropologjinë kulturore*, SHBLU, Tiranë, 2010, f. 137.

³³ Mircea Eliade, *Images and symbols, Studies in Religious Symbolism*, the english translation Harvill Press Manufactured in the United States of America, 1961, f. 12.

³⁴ Termi “subkoshienca” nuk duhet marrë thjesht si përkufizim i asaj që nuk është e pranishme në fushën e koshiencës. Për sqarime të hollësishme, në lidhje me nënvetëdijen e autorit dhe lidhjen e saj me tekstin, shih: Ann Jeferson, David Roby, *Teoria letrare moderne, një paraqitje krahasuese*, përkthet: Floresha Dado, “Albas”, Tiranë, 2016, f. 210 e tutje.

Vetë titulli i veprës na jep numrin tre, duke na asociuar me numrin e harqeve që ka ura. Tri periudhat perandorake nëpër të cilat kishte kaluar vendi ynë, dy prej të cilave kishin marrë fund, dhe e treta që po vinte. Ura nuk është vetëm lidhëse e brigjeve të Ujanës, por ajo lidh edhe tri përmasat kohore të historisë së Shqipërisë. Pastaj kemi në këmbët e urës tri shenjat paralajmëruese për shkatërrimin e saj.

Ndërkaq më tutje, vijon përralla afrikane për betejën e fuqishme mes dy bishave superiore. Bishës ujore, krokodilit, dhe asaj tokësore, tigrin.

*“Tri herë rresht tigrin i qe hedhur mbi shpinë krokodilit dhe të tria herët kthetrat e tij kishin rrëshqitur mbi luspat e forta të përbindëshit”.*³⁵

Me kuptimet simbolike të fjalëve, ndërlidhur me numrin tre, kuptohen të gjitha vuajtjet e shqiptarit që rezultojnë të jenë triumfuese, karshi tri pushtimeve të mëdha që ai i mbarti me shekuj mbi shpinë pa u përkulur asnjëherë!

Simbole të ndryshme, qofshin biblike ose universale, apo mendimet mitike për ringjalljen e të vdekurve, mendimi hyjnzues për ylberin, e refleksione të tjera të ngjashme, janë përbërës kryesorë të veprës që meritojnë studim të mirëfilltë në të ardhmen.

Bibliografia:

- Barthes. Roland, *Miti sot*, përktheu nga anglishtja: Ballsor Hoxha, revista letrare “Jeta e Re”, nr. 2, Prishtinë, 2013, f. 296 – 309.
- Chevrel. Yves, *Letërsi e krahasuar*, “Albini”, Tiranë, 2002.
- Dado. Floresha, *Letërsi e painterpretuar*, “Bota Shqiptare”, Tiranë, 2010.
- Dhama. Doc. Todi. *Fjalor i mitologjisë*, “Rilindja”, Prishtinë, 1988.
- Eliade. Mircea, *Images and symbols*, *Studies in Religious*

³⁵ Ismail Kadare, *Ura me tri harqe*, Vepra 10, “Onufri”, Tiranë, 2008, f. 37.

Symbolism, the english translation Harvill Press, Manufactured in the United States of America, 1961.

- Isufaj. Dr. Viola, *Rikthimi i mitit në veprën e Ismail Kadaresë, "Onufri"*, Tiranë.
- Jakllari. Adem, *Imazhi mitik i botës dhe ritmet kozmike në veprën e Kadaresë*, Materialet e punimeve të Seminarit XXXIII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Prishtinë, f. 18-30.08.2014, Biblioteka Kombëtare e Kosovës, "Pjetër Bogdani", Prishtinë, 2015, f. 25-29.
- Jakllari. Prof. Dr. Adem, *Leksione për antropologjinë kulturore*, Shtëpia Botuese e Librit Universitar (SHBLU), Tiranë, 2010.
- Jeferson. Ann. Roby. David, *Teoria letrare moderne (një paraqitje krahasuese)*, përktheu: Floresha Dado, "Albas", Tiranë, 2016.
- Kadare. Ismail, *Ftesë në studio, "Onufri"*, Tiranë, 2012.
- Kadare. Ismail, *Ura me tri harqe*, Vepra 10, "Onufri", Tiranë, 2008.
- Mandalâ. Matteo, *Urat krontopike kadareane, "Hora e Arbëreshëvet"*, tetor 2008. Në: Kadare, *Ura me tri harqe*, Vepra 10, "Onufri", Tiranë, 2008.
- Mirdita. Zef, *Mitet dhe mitologjia në antikë, "Rilindja"*, Prishtinë, 1988.
- Tirta. Mark, *Mitologjia ndër shqiptarë, "Mësonjëtorja"*, Tiranë, 2004.
- Uçi. Alfred, *Mitologjia, Folklori, Letërsia, "Naim Frashëri"*, Tiranë, 1982.
- Ymeraj, Dr. Ermira. *Komunikimi i kodit të flijimit në letërsi si tekst origjinal (I. Kadare, I. Andriq, K. Varnali, R. Qosja)*, Punim nga Konferenca shkencore kushtuar Akademikut Idriz Ajeti, mbajtur në Universitetin "Ukshin Hoti" Prizren, Fakulteti i Filologjisë, "Vertigo", Prizren, 2015, f. 262.
- Xhiku, Ali. *Pak fjalë për marrëdhëniet e traditës letrare me mitologjinë*, revista shkencore-kulturore tremujore "Perla", Viti XI 2006 Nr. 3 (42), Botuesi: Fondacioni Kulturor "Saadi Shirazi", Tiranë, f. 47-51.

- Wellek, R. Warren A, *Teoria e letërsisë*, Përktheu nga origjinali: Abdurrahman Myftiu, Tiranë, 2007.
- Burimet nga interneti:
- Dardha, Eva. *Motivi i murimit në romanin Ura me tri harqe të I. Kadare*, Tiranë, 2015, në: http://www.academia.edu/36441924/Motivi_i_murimit_ne_romanin_Ura_me_tri_harqe_I.Kadare.
- <https://filologjia.uni-pr.edu/getattachment/Seminari/Seminari-XXXIII---2.pdf.aspx> f. 25-29.
- <http://www.panorama.com.al/letersia-fantastike-e-kadarese-rrefyer-nga-gjekmarkaj/>.
- <http://www.kultplus.com/opinione/perqasje-per-romanin-e-ismail-kadarese-ura-tri-harqe/>.